



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT KORÇE

RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TE BUXHETIT TE VITIT 2018 PER PERIUDHEN 8 MUJORE

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” paraqitim Këshillit të Qarkut “Raportin për monitorimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2018 për periudhën 8/mujore”

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2018 është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi si më poshtë:

- *Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*
- *Ligjin nr. 68 /2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.*
- *Ligjin nr 11/2017 “ Për buxhetin e vitit 2018” neni 16.*
- *Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018.“ Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.2 dt 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018“.*
- *Në Vendimin e Keshillit të Qarkut nr. 13 date 18.12.2017 “Per miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2018”*

Raporti paraqet punën e administratës të Këshillit të Qarkut Korçë në zbatimin e politikave të percaktuara nga Keshilli i Qarkut si në realizimin e burimeve të ardhurave ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një ritje të cilësive të shërbimeve të ofruara. Ai përqëndrohet kryesisht në veprimet e ndërmarra dhe arritjet në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, si dhe në menaxhimin dhe administrimin sa më të mirë të shpenzimeve për periudhën 8/mujore 2018.

CILI ËSHTË MISIONI I QARKUT KORÇE

Misioni i Këshillit të Qarkut Korçë është hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore në plotësim të funksioneve të veta ligjore, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj. Këshilli i Qarkut ofron bashkëpunimin dhe koordinimin midis qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore, si dhe bashkëpunimin e koordinimin e politikave midis njesive të qeverisjes vendore të rajonit.